

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin korrik

2023

gusht 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin korrik

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, gusht 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit korrik 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i trembëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetët nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.


Kategoritë monitoruese janë:

- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit


KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Të dhënat rreth keqinformimit të muajit korrik 2023 tregojnë se artikujt e vlerësuar si "clickbait" dhe dezinformatë, të publikuara nga media dhe publikues të ndryshëm kanë dominuar ekosferën e keqinformimit për dhe rreth Kosovës.

Përderisa gjatë muajit të paraprak (qershor 2023) vlerësimi "Lajmi i rremë" ishte në krye të kategorive të keqinformimit, gjatë muajit korrik 2023, artikujt "clickbait" zënë vendin e parë me 29%, duke u pasuar nga dezinformata me 25%. Pra, në muajin korrik rikthehet renditja më e shpeshtë e kategorive të vlerësimit në monitorimet mujore ku dominojnë "clickbait" dhe dezinformata. Këto të dyja pasohen nga "lajmi i rremë" me 16% dhe mashtrimi me 11%. Përmbajtja e paverifikuar është e pesta me 6%, duke u pasuar nga teori konspirative me 5% dhe gabimi me 2%. "Lajmi i rremë" ka rënë në vendin e tretë, për shkak të rënies së përmbajtjeve në mediat sociale lidhur me politikën, por të gjitha "lajmet e rreme" kanë qenë në fushën e sigurisë. Ndërkaq, janë shtuar përmbajtjet "clickbait" nga fusha e kronikës së zezë dhe sociale.

Arsyeja e kthimit të "clickbait" në vend të parë si kategori vlerësuese është për shkak se, një përqindje e konsiderueshme e përmbajtjeve të publikuar nga fusha e politikës, sociale dhe kronikës së zezë kanë marrë vlerësimin "clickbait". Ndërkaq, shtimi i numrit të përmbajtjeve në fushën e politikës dhe sigurisë, ku një përqindje e dukshme prej tyre janë vlerësuar si dezinformatë, ka ndikuar që kjo e fundit të zë vendin e dytë, si rrjedhojë kategoria e "lajmit të rremë" ka rënë në pozitën e tretë.



29% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin "clickbait".

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. “Clickbait”

Të gjitha artikujt “clickbait” janë publikuar nga publikues në gjuhën shqipe, ku shumica prej tyre janë publikuar nga media (portale informative) dhe një përqindje e vogël nga portalet e dyshimta dhe publikues në mediat sociale. Një pjesë e madhe e përmbajtjeve “clickbait” janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë sociale (rreth 20% të dyja së bashku). Për më tepër, në këto publikime keqinformuese kanë mbizotëruar artikuj me lajme për raste të vdekjeve, vrasjeve (si, psh. vdes gazetari i njohur, burri vret të fejuarin e ish të dashurës dhe më pas veten) e tërmete, por që nuk u është bërë e ditur vendndodhja e ngjarjes. Gjithashtu, në kuadër të “clickbait” janë përfshirë edhe temat që kishin të bënin me qëndrimet e SHBA-së për zhvillimet e fundit në Kosovë, raportet Kurti-Rama, mbështetjet e të rinjve nga Qeveria e Kosovës dhe subvencionimin e Studentëve të Kosovës.

03. Lajm i rremë

Lajme të rreme janë publikuar kryesisht në fushën e sigurisë dhe më pak në fushën e politikës. Sa i përket fushës së sigurisë, ato janë krijuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale, në gjuhën shqipe, rreth pajisjes apo furnizimit të FSK-së me armatim. Edhe pse zyrtarisht është bërë e ditur se shteti i Kosovës ka blerë dronë “Bayraktar”, publikuesit në mediat sociale kanë publikuar përmbajtje të rreme me pretendimin se janë blerë edhe pajisje të tjera ushtarake nga Turqia. Shumica e përmbajtjeve të rreme në mediat sociale janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa një numër i vogël në gjuhën serbe. Pothuajse të gjitha lajmet e rreme që ndërlidhen me zhvillimet rreth blerjes së armatimit nga FSK, duke e rradhitur kështu këtë kategori si të tretën.

05. Përmbajtje e paverifikuar

Të gjitha publikimet keqinformuese të vlerësuara si “Përmbajtje e Paverifikuar”, janë krijuar dhe shpërndarë në fushën e politikës dhe sigurisë në përmbajtje të cilat ndërlidhen me veriun dhe pajisjen e FSK-së me mjetet ushtarake. Shumica e përmbajtjeve të paverifikuara janë shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale, nga to shumica në gjuhën shqipe.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Gabim”, “Përmbajtje e paverifikuar/Teori konspirative/Pseudoshkencë”, “Clickbait/Dezinformatë”, “Dezinformatë/Satirë” dhe “Manipulim i fakteve”.

02. Dezinformatë

Publikues të ndryshëm në mediat sociale kanë publikuar më së shumti dezinformata gjatë këtij muaji në fushën e politikës dhe sigurisë. Dezinformatat në fushën e sigurisë ndërlidhen me veriun, ndërkaq në fushën e politikës me pretendimet e pavërteta për rrëzimin e Qeverisë Kurti. Përmbajtjet dezinformuese për veriun e publikuara në gjuhën shqipe nga publikues në media sociale lidhen me temat e zvogëlimi të pranisë policore në veri të Kosovës dhe koordinimin me KFOR-in. Ndërkaq, përmbajtjet dezinformuese rreth temës së rrëzimit të Qeverisë Kurti, përfshinin tematikat që përmbajnë pretendime të rreme të tilla si “ish-presidenti i SHBA-së, Bill Clinton paralajmëron fund tragjik të Kurti” apo e edhe se si “Serbia përkrah rrëzimin e Qeverisë Kurti”.

04. Mashtrim

Të gjitha publikimet keqinformuese të vlerësuara si mashtrim janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues në mediat sociale. Shumica prej tyre janë në gjuhën shqipe nga faqe të ndryshme në Facebook për çështje sociale, si shpallje, dhënie të kredive, lidhje dashurie, lojë shpërblyese etj.

06. Teori konspirative


Një numër i vogël i artikujve keqinformues gjatë këtij muaji janë vlerësuar si teori konspirative. Artikujt me përmbajtje të vlerësuara si teori konspirative janë shpërndarë në fushën e politikës, sociale dhe shëndetësisë nga media reale dhe publikues në media sociale kryesisht në gjuhën shqipe. Temat e vlerësuara në këtë kategori trajtojnë çështjen e ndikimit të Kurtit në politikën e brendshme në Serbi dhe përmbajtje për pandeminë.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Temat kryesore që kanë mbizotëruar këtë muaj janë pajisjet ushtarake të FSK-së dhe veriu i Kosovës. Përkundër faktit që në muajin e kaluar (qershor 2023) tema e veriut kishte dominuar me 27% pas ngjarjeve politike e të sigurisë në komunat veriore të vendit, në këtë muaj përmbajtjet keqinformuese rreth veriut kanë rënë në 10%.

Rënia e publikimeve për veriun nga media dhe publikues të ndryshëm përputhet me dinamikën e zhvillimeve dhe ngjarjeve politike e të sigurisë në veriun e Kosovës gjatë muajit korrik 2023. Çështja e Policisë së Kosovës, zvogëlimi i prezencës së tyre në dhe rreth objekteve komunale në veri, si dhe prezenca e tyre më lejen apo koordinimin e KFOR-it, si kërkesë nga ndërkombëtarët për deeskalim të situatës, ishin temat që u përdorën më së shumti për përmbajtje keqinformuese. Publikimet keqinformuese për veriun janë krijuar dhe shpërndarë më së shumti nga media dhe publikues në media sociale, kryesisht në gjuhën shqipe dhe më pak në atë serbe. Tematikat e përmbajtjeve në gjuhën serbe kishin të bënin me pretendime të pabaza për ekzistencën e dronëve në veri, si dhe dhunën e njësisë speciale të Policisë së Kosovës ndaj komunitetit serb atje.

Përmbajtjet keqinformuese rreth pajisjeve ushtarake të FSK-së rrodhën si pasojë e spekulimeve për blerjen e armatimit të shtetit të Kosovës nga Turqia, ku zyrtarisht u bë e ditur vetëm për blerjen e dronëve “Bayraktar”. Të gjitha përmbajtjet keqinformues mbi këtë temë janë publikuar nga publikues në mediat sociale dhe atë kryesisht në gjuhën shqipe.

Gjatë këtij muaji ka pasur përmbajtje keqinformuese për temat, si vdekje (p.sh vdes gazetari i njohur, gjendet i vdekur një person në park, gjendet trupi i pajetë i një foshnjeje), rrëzimi i Qeverisë Kurti, vrasje (burri vret të fejuarën dhe pastaj veten), deklarata të politikanëve për politikën e Qeverisë së Kosovës etj.



37% e temave kryesore janë për veriun dhe zhvillimet atje, si dhe për furnizimin me pajisje ushtarake të FSK-së.

Analizë e kontroleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Armatosja e FSK

Të gjitha përmbajtjet lidhur me furnizimin ushtarak të FSK-së janë publikuar në fushën e sigurisë. Shumica prej tyre janë vlerësuar në këto kategoritë “Lajm i rremë” dhe “Përmbajtje e paverifikuar” të cilat janë shpërndarë nga publikues në mediat sociale. Lajmet e rreme janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale, në gjuhën shqipe, pënderisa përmbajtja e paverifikuar është publikuar në median sociale Reddit, në gjuhën angleze, që përmban gjoja një dokument duke pretenduar të paraqitet si marrëveshje për blerjen e armëve të FSK-së nga Turqia.

03. Vdekje

Për këtë temë janë shpërndarë kryesisht artikuj të vlerësuar si “clickbait” dhe dezinformata. Vlerësime “clickbait” kanë marrë kryesisht artikuj/publikime që kanë trajtuar ngjarje me pretendime nga kronika e zezë dhe çështjet sociale, ndërsa dezinformata vetëm në fushën e kronikës së zezë. Përmbajtje “clickbait” janë publikuar nga media dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe, ndërkaq dezinformata nga publikues në mediat sociale në gjuhën shqipe.

02. Veriu

Pjesa më e madhe e përmbajtjeve keqinformuese për veriun këtë muaj janë publikuar në kuadër të fushës së sigurisë, ndërsa një përqindje e vogël në fushën e politikës. “Dezinformata”, “Lajm i rremë”, “Manipulim i fakteve” dhe “Përmbajtje e paverifikuar” janë kategoritë keqinformuese me të cilat janë vlerësuar të gjitha përmbajtjet rreth veriut. Dezinformatat dhe manipulimi i fakteve janë publikuar nga media në gjuhën shqipe dhe serbe, lajmi i rremë dhe përmbajtja e paverifikuar janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale, në gjuhën shqipe dhe serbe. Çështja e Policisë së Kosovës, koordinimi me KFOR-in dhe prezenca e tyre në dhe rreth objekteve të komunave në veri ishin temat për të cilat më së shumti ka pasur keqinformime.


04. Rrëzimi i Qeverisë Kurti

Përmbajtjet keqinformuese lidhur me rrëzimin e Qeverisë Kurti janë vlerësuar dezinformata me tematikë politike. Të gjithë artikujt për këtë temë janë publikuar nga llogari apo faqe në mediat sociale, në gjuhën shqipe. Në bazë të monitorimit mujor nga hibrid.info, janë trajtuar edhe pretendime të pasakta rreth përfshirjes së Serbisë në rrëzimin e Qeverisë Kurti dhe, të pavërteta rreth paralajmërimit të ish-presidentit amerikan, Bill Clinton, se “Kurti do të ketë fund tragjik”.

Llojet e fushave

Në bazë të matjeve të bëra për muajin korrik 2023, faqe apo llogari të ndryshme në mediat sociale, në gjuhën shqipe, kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën politike. Këta artikuj keqinformues trajtojnë tema të ndryshme politike, si veriu, politikat e Kurtit, deklaratat e politikanëve dhe pretendimet e pavërteta të ambasadorit të SHBA-së në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier për opozitën politike në Kosovë.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Në raport me muajin paraprak (qershor 2023), kur përmbajtjet keqinformuese në sferën politike dhe të sigurisë kishin mbizotëruar dukshëm për shkak të zhvillimeve dinamike që i ndërlidhin këto të dy fusha, në korrik 2023, temat në fushën politike e të sigurisë kanë pësuar rënie në përqindje, pavarësisht se edhe këtë muaj janë fushat kryesore të keqinformimit. Në këtë drejtim, gjatë këtij muaji vërehet rënie e dukshme prej 14% e artikujve në fushën politike me muajin paraprak (nga 42% në muajin qershor 2023 në 28% në muajin korrik 2023). Fusha e politikës pasohet nga ajo e sigurisë, e cila ka pësuar një rënie të lehtë prej 5% në krahasim me muajin paraprak (nga 29% në muajin qershor 2023 në 24% në muajin korrik 2023). Pavarësisht këtyre të dhënave monitoruese, nëse këto dy fusha llogariten së bashku, atëherë 52% e të gjithë artikujve keqinformues të publikuar në muajin korrik 2023 janë mbizotëruar nga tematikat politike dhe të sigurisë, e cila dëshmon për dominim në masë të madhe të tyre, marrë parasysh se ato ndërlidhen njëra me tjetrën, kryesisht sa i përket veriut të Kosovës.

Nga ana tjetër, përmbajtjet keqinformuese në fushën sociale kanë shënuar rritje me 12%, krahasuar me muajin qershor 2023. Rritja në këtë fushë erdhi si rezultat i përmbajtjeve keqinformuese që lidheshin me disa tema sociale, si ndihma financiare për shërim, subvencione për fëmijë nga Komuna e Prishtinës, mosha e pensionimit

etj. Ajo pasohet nga kronika e zezë, e cila ngjashëm ka shënuar rritje prej 10% krahasuar me muajin qershor 2023.

Shumica e publikimeve keqinformuese me përmbajtje politike janë krijuar dhe shpërndarë nga publikuesit në media sociale me 19%, pasuar nga media reale me 8% dhe portalet e dyshimta me 2%. Në fushën e politikës, 13% e përmbajtjeve keqinformuese janë dezinformata, 6% “clickbait” dhe 3% përmbajtje e paverifikuar. Shumica e dezinformatave janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale, në gjuhën shqipe, që ndërlidhen me disa deklarata të pavërteta politike të politikanëve, dhe të tilla për rrëzimin e Qeverisë Kurti. Ndërsa, artikujt “clickbait” në fushën politike janë publikuar nga media reale përmes artikujve që trajtonin raportet Kurti-Rama, për përplasjen fizike në mes deputetëve në Kuvendin e Kosovës, si dhe për mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë. Shumica e artikujve keqinformues me tematikë politike janë publikuar nga publikues në gjuhën shqipe, ndërsa një pjesë e vogël e tyre nga publikuesit në gjuhën serbe.

Keqinformimet që kanë trajtuar temat e sigurisë më së shumti janë vlerësuar si lajme të rreme (13%), dezinformata (8%) dhe përmbajtje e paverifikuar (2%). Lajmet e rreme janë publikuar kryesisht nga faqe dhe llogari në mediat sociale, në gjuhën shqipe, lidhur me pajisjen së FSK-së me mjete ushtarake. Nga ana tjetër, dezinformatat në fushën e sigurisë janë publikuar nga media në gjuhën serbe për temën e veriut dhe për veteranët e UÇK-së, ku protesta e organizuar nga ta për mos përfshirjen e pensioneve të tyre në Ligjin e pagës minimale, u interpretua në mënyrë të rreme nga mediat serbe si kërkesë e parave për vrasjen e serbëve. Ndërsa, një pjesë tjetër e dezinformatave, në përqindje më të vogël, janë publikuar nga media në gjuhën shqipe lidhur me veriun dhe raportet Kosovë-NATO. Edhe në fushën sigurisë, shumica e publikimeve keqinformuese janë shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale (16%), kryesisht në gjuhën shqipe me 13%, të cilat pasohen nga mediat reale me 8%, ku prinë publikimet e publikuesve gjuha shqipe me 5% dhe ato në gjuhën serbe me 3%.

Sa i përket artikujve keqinformues për çështje sociale, të gjitha prej tyre janë publikuar nga media dhe publikues në gjuhën shqipe për tema të ndryshme, si vdekje të ndryshme, mbështetje financiare, subvencionime për fëmijët etj. Kurse, keqinformimet për kronikën e zezë janë publikuar nga media dhe publikues (media sociale dhe portale të dyshimta) në gjuhën shqipe për temat e dhunimeve, vrasjeve, vdekjeve dhe tërmeteve.



93% e përmbajtjeve keqinformuese janë për politikën, sigurinë, çështjet sociale, kronikën e zezë dhe motin.

4


Llojet e publikuesve

Për dallim nga muaji qershor 2023 dhe muajt tjerë paraprak, kur mediat reale kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese lidhur me ngjarje dhe zhvillime të ndryshme rreth Kosovës, në muajin korrik 2023, ishin faqe e profile në mediat sociale, nga ku u keqinformua më së shumti. Kjo si rezultat i asaj se, shumica e dezinformatave dhe lajmeve të rreme, si dhe një pjesë e mashtrimeve dhe përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar nga publikues në media sociale.

Të dhënat nga monitorimi tregojnë se 50% e përmbajtjeve keqinformuese janë shpërndarë nga faqe dhe llogari në mediat sociale, 39% në mediat reale, pasuar me 11% nga portale të dyshimta.

Krahasuar me muajin paraprak (qershor 2023), vërehet se këtë muaj ka pasur rritje të konsiderueshme prej 14% të përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale, nga 36% në muajin qershor 2023 në 50% për këtë muaj.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




89% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në mediat sociale (50%) dhe mediat reale (39%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës një mujore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në raport me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Në muajin korrik 2023, 34% e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, (që përbënë mostrën më të madhe të monitorimit) janë publikuar nga mediat, 11% nga portale të dyshimta dhe 45% nga publikues në mediat sociale. Ndërsa përmbajtje keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar nga 5% e mediave të monitoruara për publikime me përmbajtje për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë dhe 3% nga mediat sociale, konkretisht në kanalet në telegram.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Faqe dhe llogari në mediat sociale, në gjuhën shqipe, kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese në muajin korrik 2023, pasuar nga mediat reale dhe pjesa tjetër më e vogël nga portalet e dyshimta. Edhe pse në muajin qershor 2023 kishte dominuar lajmi i rremë si kategori në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe, në muajin korrik kategoria “clickbait” radhitet e para me 29%, për shkak të përmbajtjeve me tematikë të vrasjeve, vdekjeve e aksidenteve që nxisin klikimin, ndërsa dezinformata e dyta me 22%. Në vendin e tretë është lajmi i rremë me 13%, ndërsa në të katërtin mashtrimi me 11%. Politika ka qenë tema kryesore e keqinformimit që është trajtuar nga publikuesit dhe mediat në gjuhën shqipe për shkak se shumica e dezinformatave dhe një pjesë e caktuar e përmbajtjeve “clickbait” janë nga kjo fushë. Politika pasohet nga çështjet sociale në vendin e dytë, ndërsa siguria dhe kronika e zezë radhiten në vendin e tretë, respektivisht të katërt më një dallim të vogël nga fusha sociale e cila radhitet e dyta.

03. Publikimet në gjuhën angleze

Gjatë muajit korrik 2023, një artikull keqinformuese është publikuar nga llogari në mediat sociale në gjuhën angleze. Përmbajtja e publikuar në Reddit, ku janë publikuar dokumente për të cilat pretendohej se janë marrëveshje zyrtare për blerjen e armëve nga Turqia nga ana e Kosovës.

02. Publikimet në gjuhën serbe


Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në gjuhën serbe janë tema politike dhe të sigurisë në lidhje me ngjarjet në Kosovë gjatë muajit korrik 2023. Sa i përket kategorive vlerësuese të keqinformimit, dezinformata dhe lajmi i rremë ndajnë të njëjtën përqindje, duke u pasuar nga përmbajtje konspirative. Përmbajtjet dezinformuese në gjuhën serbe ndërlidhen me temën e veriut të Kosovës dhe çështjen e veteranëve të UÇK-së, ku protestën e tyre për përfshirje e pensionit të tyre në Ligjin për pagën minimale e keqintepretuan si kërkesë të parasë për vrasjen e serbëve që jetojnë në Kosovë. Ndërkaq, lajmet e rreme ishin për pretendimet se Egjipti e ka tërhequr njohjen e Kosovës, për prezencën e dronëve në veri të Kosovës dhe maltretimin e komunitetit serbe nga Policia e Kosovës. Publikuesit në gjuhën serbe publikuan edhe përmbajtje konspirative me pretendimin se kryeministri Kurti po përfshihet në politikën e brendshme të Serbisë.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Përderisa në muajin qershor 2023 kishte rënie të përmbajtjeve keqinformuese në Facebook, ku TikTok u radhit e para, në muajin korrik 2023, Facebook kthehet në pozitën e parë me një rritje të theksuar prej 28%. Pra, 68% e përmbajtjeve keqinformuese u publikuan dhe shpërndanë në Facebook, pasuar nga TikTok me 23% dhe një përqindje e vogël në mediat tjera sociale, si Telegram (6%) dhe Reddit (3%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje analizon, përmes të dhënave monitoruese, ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: llogarive, faqeve dhe profileve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Gjatë muajit korrik, faqet në Facebook (52%) kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese lidhur me zhvillimet në Kosovë dhe pjesa tjetër e përmbajtjeve keqinformuese në këtë media sociale janë publikuar nga profile dhe media. Derisa në muajin qershor 2023, llogaritë në TikTok kishin shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese, në këtë muaj ajo (23%) radhitet e dyta pas Facebook.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Pjesë dërrmuese e publikimeve keqinformuese në Facebook ndërlidhen me politikën dhe sigurinë. Përmbajtjet politike përshijnë disa deklaratatë të pavërteta të politikanëve, publikime për veriun e Kosovës, për mundësinë e rrëzimit të Qeverisë Kurti kurse në fushën e sigurisë kishte publikime rreth pajisjes së FSK-së më armatim ushtarak. Përmbajtjet keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe në Facebook kategorizohen si dezinformata (19%), mashtrim (16%) dhe lajm i rremë (16%). Dezinformatat ndërlidhen me tema të zhvillimeve të brendshme politike, mashtrimet kishin të bënin me lojë shpërblyese dhe dhëni të kredive, ndërsa lajmet e rreme me pajisjen e FSK-së më armë.

02. TikTok


Shumica e publikimeve keqinformuese të llogarive në TikTok janë në fushën politike dhe të sigurisë. Temat politike ndërlidhen me politikën e Kurtit, deklaratatë të pavërteta të ambasadorit amerikan Jeffrey Hovenier për Opozitën, si dhe pretendimet për rrëzimin e Qeverisë Kurti. Përmbajtjet keqinformuese në fushën e sigurisë të publikuara në TikTok kanë të bëjnë me pajisjen e FSK-së me armatim dhe veriun e vendit. Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të llogarive në TikTok janë publikuar në gjuhën shqipe dhe kategorizohen si dezinformata (10%), lajm i rremë (10%) dhe teori konspirative (3%).

03. Twitter, Reddit dhe Telegram

Publikimet në mediat tjera sociale janë dukshëm në përqindje më të vogël në krahasim me Facebook dhe TikTok. Publikimet në Telegram janë në gjuhën serbe për tema të sigurisë dhe politikës, kurse ato në Reddit janë në gjuhën angleze, në fushën e sigurisë dhe sociale. Kanalet në Telegram publikuan lajme të rreme rreth ekzistencës së dronëve në veri dhe tërheqjen e njohjes së Kosovës nga Egjipti. Ndërsa, artikulli i publikuar në Reddit ishte përmbajtje e paverifikuar lidhur me dokumente të marrëveshjeve për blerjen e armëve nga Turqia.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.




Institucionet e sigurisë kanë dominuar pashmangshëm mbi institucionet tjera në raportimet keqinformuese të mediave dhe publikuesve të ndryshëm. Përdërisa gjatë muajit prill, maj e qershor, institucioni më i përfolur në përmbajtjet keqinformuese ishte Policia e Kosovës, në muajin korrik ky institucion radhitet i dyti për shkak të zhvillimeve më të reduktuara në veri dhe përmbajtjeve keqinformuese rreth tyre duke u ndërlidh me Policinë. Ndërkaq, në muajin korrik, për herë të parë Forca e Sigurisë së Kosovës zë vendin e parë si institucioni më i përfolur si rezultat i blerje së donëve “Bayraktar” nga Turqia, ngjarje kjo që ndikoi në krijimin e përmbajtjeve keqinformuese.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka rezultuar si institucioni më i përfolur nga publikimet keqinformuese gjatë muajit korrik 2023, si rezultat i publikimeve keqinformues lidhur me tematikën e furnizimit me pajisje ushtarake të FSK-së. Ndërkaq, Policia e Kosovës u përfol më së shumti lidhur me zhvillimet në veriun e Kosovës. FSK-ja kryesisht u përfol në përmbajtjet keqinformuese nga publikuesit në mediat sociale në gjuhën shqipe, ndërsa Policia e Kosovës nga mediat reale në gjuhën serbe dhe shqipe.

Institucione ose organizata tjera të përfolura janë Komuna e Prishtinës, grupi mercenar “Wagner” dhe UÇK-ja.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Bazuar në monitorimin e të dhënave për muajin korrik 2023, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti vazhdon të jetë figura më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të krijuara dhe shpërndara nga publikues të ndryshëm. Kurti u përfol në dezinformata të publikuesve në mediat sociale, në gjuhën shqipe, lidhur me përfshirjen e tij në politikën e brendshme të Serbisë, përmbajtjen “clickbait” të mediave reale në gjuhën shqipe me keqinterpretim të deklaratave për zgjedhje të parakohshme, si dhe dezinformata të publikuar nga mediat në gjuhën serbe se Kurti po vazhdon t’i terrorizoj serbët në Kosovë nëpërmjet Policisë së Kosovës.

Gjithashtu, Kurti u përfol edhe në përmbajtje të tjera keqinformuese në kontekst me personalitete tjera. Në këto përfshihen teori konspirative të mediave në gjuhën serbe për krijimin e një partie politike në Serbi së bashku me ish-ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, fotografi e montuar në mediat sociale me pretendimin se Kurti është takuar me ish-politikanin serb, Vojislav Koshtunica, si dhe dezinformata të tjetër se ish-presidenti amerikan, Bill Clinton ka paralajmëruar fund tragjik për Kurtin.

Figura e dytë më e përfolur gjatë këtij muaji është konspiracionisti Arianit Sllamniku, pasura nga personalitete tjera të përfolura siç janë ish-polici i vrarë Enver Zymeri, Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Operacione i NATO-s, Thomas Goffus, ministri Faton Peci, ish-kryeministri Isa Mustafa etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 korrik 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit korrik 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit korrik 2023, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj “clickbait” me 29% duke mbizotëruar mbi kategoritë tjera keqinformuese. “clickbait” pasohet nga dezinformata me 26%, lajmi i rremë me 16% dhe përmbajtjet mashtruese zënë vendin e katërt me 11%. Artikujt “clickbait” janë publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe atë sociale nga media (portale informative) dhe një përqindje e vogël nga portalet e dyshimta dhe publikues në mediat sociale, në gjuhën shqipe. Përmbajtjet dezinformuese janë publikuar nga publikuesit në mediat sociale, në gjuhën shqipe, në fushën e sigurisë dhe politikës për veriun, mundësinë e rrëzimit të Qeverisë Kurti, praninë e Policisë së Kosovës në veri etj. Ndërkaq, lajmet e rreme janë shpërndarë nga publikues në mediat sociale, kryesisht në gjuhën shqipe, në fushën e sigurisë lidhur me pretendime rreth pajisjeve ushtarake të FSK-së. Edhe përmbajtjet mashtruese janë publikuar në mediat sociale, në gjuhën shqipe, për tema të ndryshme, si dhënie të kredive, lidhje dashurie, lojë shpërblyese etj.

Veriu dhe pajisja e FSK-së me mjete ushtarake ishin dy temat kryesore të keqinformimit gjatë këtij muaji. Publikimet keqinformuese në gjuhën shqipe rreth veriut janë për praninë e Policisë së Kosovës në veri me lejen e KFOR-it apo jo, ndërsa publikimeve e mediave në gjuhën serbe kanë raportuar keqinformime për ekzistencën e dronëve në veri, si dhe pretendimet e tyre për dhunën e shkaktuar nga Policia e Kosovës ndaj komunitet serb. Përmbajtjet keqinformuese rreth furnizimit me armë të FSK-së u publikuar nga publikuesit në mediat sociale, kryesisht në gjuhën shqipe. Sa i përket fushave mbi të cilat u keqinformua më së shumti, politika është ajo që kryeson me 29%, e cila pasohet nga siguria me 24% dhe fusha sociale me 21%.

Në krahasim me muajin paraprak (qershor 2023) kur mediat reale prinin në publikimin e artikujve keqinformuese, në këtë muaj mediat sociale kanë mbizotëruar dukshëm në krijimin dhe publikimin e përmbajtjeve keqinformuese prej 50% gjithsej. Pjesa tjetër e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga mediat reale me 39% dhe portale të dyshimta me 11%. Mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe, gjatë këtij muaji, kanë publikuar më së shumti artikuj “clickbait” më 29% për tema të vrasjeve, vdekjeve dhe aksidenteve, ndërsa dezinformata zë vendin e dytë me 23%, pasuar nga lajmi i rremë me 13% dhe mashtrimi me 11%. Politika ka qenë tema kryesore e keqinformimit që është trajtuar nga publikuesit dhe mediat në gjuhën shqipe, e cila pasohet nga çështjet sociale në vendin e dytë. Ndërsa, artikujt keqinformues të mediave në gjuhën serbe janë publikuar në fushën e politikës dhe sigurisë, të cilat kanë shpërndarë kryesisht dezinformata për zhvillimet në veri të Kosovës, lajme të rreme për njohjet e Kosovës si shtet, për praninë e dronëve në veri të Kosovës dhe teori konspirative me pretendimin se kryeministri Kurti po përfshihet në politikën e brendshme të Serbisë. Prej publikuesve në mediat sociale, Facebook ka tejkaluar TikTok, në krahasim me muajin paraprak (qershor 2023), sa i përket numrit të artikujve keqinformuese duke u renditur e para me 68% të publikimeve dhe TikTok e dyta me 23%, si dhe mediat tjera sociale, si Telegram (6%), dhe Reddit (3%) me dukshëm më pak publikime keqinformuese. Shumica dërrmuese e tyre janë publikuar në gjuhën shqipe dhe temat kryesore të trajtuara janë çështjet politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Institucioni më i përfolur është Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) nga media dhe publikues në gjuhën shqipe rreth pajisjeve ushtarake të saj, ndërsa Policia e Kosovës (PK) është dyta më e përfolur nga publikues në gjuhën shqipe dhe serbe për veriun e Kosovës dhe komunitetin serb në Kosovë. Ndërkaq, sa i përket personaliteteve, kryeministri Albin Kurti ka vazhduar të ketë vëmendjen më të madhe në raportimet keqinformuese edhe këtë muaj kryesisht për zhvillime politike duke u ndërlidhur në kontekst me personaliteteve të tjera politike vendore e ndërkombëtare.

HIBRIDO.INFO